

**AKT NORMATIV**  
**Nr.18, datë 9.12.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9880, DATË 25.2.2008,**  
**“PËR NËNSHKRIMIN ELEKTRONIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 16, e nenit 3, shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 10 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Autoriteti është institucion juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit.”.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë të Autoritetit rregullohen në bazë të Kodit të Punës.”.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Drejtori i Përgjithshëm dhe nëpunësit e njëjësive teknike të përmbajtjes së Autoritetit, përveç pagës sipas kategorive të pagës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune, në masën deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë në muaj. Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune për secilën kategori përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

**Emërimi, lirimi ose shkarkimi i drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Kryeministri. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të jetë shtetas shqiptar;

b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) Të ketë diplomë të nivelit të shtatë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, “Master shkencor” apo “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” ose të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë, në fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (ICT) apo inxhinieri elektronike;

ç) Të ketë përvojë pune të paktën 10 vjet në profesion;

d) Të shquhet për aftësi profesionale në fushën e sigurisë;

dh) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

- e) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ë) Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit lirohet nga detyra kur:

- a) plotësohen kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë;
- b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;
- c) ristrukturohet institucioni;
- ç) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm të interesit;
- d) jep dorëheqjen nga detyra.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit shkarkohet nga detyra kur:

- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- b) nuk përmbushen objektivat strategjike për shkak të performancës së ulët të tij;
- c) kryen shkelje të rënda të detyrës.”.

Neni 4

Në fjalinë e parë, të nenit 55, fjalët “ ... me propozimin e ministrit përgjegjës, ...” hiqen.

Neni 5

Neni 58 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 58

#### **Ankimi dhe ekzekutimi**

1. Kundër vendimit të dënimit me gjobë apo masave të ndërprerjes së veprimtarisë bëhet ankimi në gjykatën kompetente administrative, në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen, në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

3. Gjoha është titull ekzekutiv, që vilet nga Autoriteti dhe derdhet në buxhetin e shtetit.”.

Neni 6

Në pikën 2, të nenit 59, fjalët “ ... ministri përgjegjës ...” zëvendësohen me “ ... Kryeministri ... “.

Neni 7

#### **Dispozitë kalimtare**

Me miratimin e këtij akti normativ, përjashtimisht për vitin 2022, autorizohet drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të negociojë e të nënshkruajë amendimin e marrëveshjes së rinovuar të partneritetit strategjik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “*Microsoft Corporation*” dhe të dërgojë marrëveshjen e nënshkruar për miratim në Këshillin e Ministrave.

Neni 8  
**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**